



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.788/2 Prot.

Tiranë, më 11/06/ 2021

V E N D I M

Nr. 105, Datë 11 /06/ 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.96 regj, datë 24.05.2021, paraqitur nga ankuese D.O, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat². Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesja parashtron se, me urdhrin nr.7675, datë 01.09.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ankuesja është emëruar në detyrën sekretare/protokolliste/arkiviste/operatore, pranë IEVP Berat. Marrëdhëniet e punës kanë filluar në datën 01.10.2015. Pas përfundimit të periudhës së provës, ankuesja shpjegon se është lidhur kontrata individuale e punës në datë 05.01.2016, me afat të pacaktuar. Detyrat që ankuesja duhet të kryente në bazë të kontratës së punës, kanë qenë, të protokollonte çdo dokument në institucion dhe të kryente çdo detyrë tjetër të përcaktuar nga drejtori. Ankuesja shpjegon se, puna e saj ishte e lidhur me kushtet e përgjithshme shëndetësore që ajo kishte, pasi vunte nga sëmundja e “sklerozë multiple”. Ankuesja shpjegon se para fillimit të punës ajo ishte vlerësuar nga KMCAP si person me aftësi të kufizuara, fakt ky që sipas saj ishte i njohur nga punëdhënësi.

Gjatë ecures së marrëdhënieve të punës, ankuesja shprehet se ka kryer të gjitha detyrat që i janë caktuar nga punëdhënësi dhe nuk ka patur vërejtje apo masa disiplinore.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën IEVP Berat.

Me shkresën nr.456 datë 06.02.2017, I EVP Berat, ka njoftuar organin epror, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve se : “ Sekretarja/protokollistja e institucionit, znj. D.O, ka disa kohë që nuk paraqitet në punë. Duke patur parasysh se ajo ka qenë për një periudhë kohe të gjatë me raport, kemi pritur që ajo të sjellë sërish raportin, por nuk është përligjur dhe ka refuzuar të paraqitet”. Ankuesja shpjegon se, me urdhrin nr.486/2, datë 08.02.2017, të I EVP Berat është urdhëruar ngritja e Komisionit të Shqyrtimit të Masave Disiplinore. Me shkresën nr. 486/1 prot datë 08.02.2017, Sektori i Burimeve Njerëzore të I EVP Berat ka njoftuar Komisionin Disiplinor se, punonjësja D.O nuk ka masa disiplinore të dhëna ndaj saj për një periudhë 1-vjeçare. Po në të njëjtën datë, I EVP Berat ka nxjerrë shkresën nr.486/3 datë 08.02.2017 me titull “Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore, me motivacionin “braktisje e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshmërisë për 7 ditë pune ose më shumë”.

Ankuesja pretendon se njoftimi për fillimin e ecurisë disiplinore, është firmosur nga përgjegjësi i burimeve njerëzore, në mungesë të kompetencave për të përfaqësuar institucionin. Në datën 08.02.2017, ankuesja shprehet se, Komisioni i Disiplinës ka mbajtur procesverbalin mbi organizimin e takimit, dhe në lidhje me të është vendosur shënimi “nuk u paraqit”. Anëtarët e Komisionit të Disiplinës janë shprehur se ndaj ankueses duhet të merret masa disiplinore “largim nga detyra”.

Me shkresën nr.486/4 datë 08.02.2017, Komisioni i Disiplinës dhe drejtuesi i I EVP Berat, i kanë propozuar organit epror, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që ndaj ankueses të merret masë disiplinore “largim nga puna”, me motivacionin “*braktisje e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshmërisë për 7 ditë pune ose më shumë*”. Bazuar në këtë propozim, ankuesja parashtron se, me urdhrin nr.1385/1 datë 03.03.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve është urdhëruar lirimi i saj nga detyra “sekretare”, në Sektorin e Arkiv-Protokollit, pranë Drejtorisë së I EVP Berat, me motivacionin “mungesë pa arsye në punë për më shumë se 7 ditë”. Në vijim, me shkresën nr.806, datë 06.03.2017, drejtuesi i I EVP Berat, ka urdhëruar lirimin e ankueses nga detyra, sipas motivacionit të mësipërm. Ankuesja shpjegon se asaj i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës në datë 06.03.2017, fakt ky që është shënuar edhe në librezën e saj të punës. Ankuesja pretendon se zgjidhja e kontratës së punës ka ndodhur për shkak të gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar, gjendje për të cilën punëdhënësi i saj ka patur dijeni.

Përfundimisht, ankuesja kërkon nga Komisioneri që të konstatojë diskriminimin e ankesës nga ana e I EVP Berat për shkak të gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar dhe rikthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ankuesja D.O, ka depozituar pranë Komisionerit ankesën nr.96 regj., datë 24.05.2021, kundër ish punëdhënësit të saj I EVP Berat, me anë të të cilës pretendon se, ka qenë viktimë e diskriminimit, pasi zgjidhja e kontratës nga ana e punëdhënësit është për për shkak të gjendjes së saj shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar.

Referuar shpjegimeve të parashtruara në ankesë, ankuesja identifikon se diskriminimi i pretenduar nga ana e saj ka ndodhur në datë 08.02.2017. Pra, rezulton se, ankuesja e lidh kohën kur ka ndodhur diskriminimi, me datën **08.02.2017**, moment në të cilin IEVP Berat i ka propozuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në cilësinë e organit epror, që ndaj ankuses të jepet masa disiplinore “largim nga detyra”, me motivacionin “braktisje e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë pune ose më shumë”. Ankuesja pretendon se, ka marrë dijeni për diskriminimin e pretenduar në datë **01.03.2020**, por nuk ka dhënë shpjegime në ankesë në lidhje me momentin e marrjes dijeni në datën e pretenduar prej saj.

Me e-mailin e datës 26.05.2021, dërguar në adresën e postës elektronike të ankuses: xxxxxxxxxxxxxxxx, Komisioneri ka kërkuar nga ankuesja shpjegime në lidhje me momentin e marrjes dijeni të pretenduar në datën 01.03.2020 dhe provat ku bazon pretendimin e saj. Në përgjigje të kësaj kërkesë, ankuesja ka dërguar shpjegimet e saj, të cilat janë protokolluar pranë institucionit të Komisionerit me nr.788/1 prot., datë 07.06.2021. Bazuar në shpjegimet e ankuses, kjo e fundit e lidh momentin e marrjes dijeni për diskriminimin e pretenduar, me momentin e konsultës që ka patur me avokatin e saj në datë 01.03.2020, me qëllim ngritjen e padisë në gjykatë lidhur me konfliktin me IEVP Berat për zgjidhjen e kontratës së punës. Ankuesja shprehet se, pas konsultës me avokatin ajo ka marrë informacionin juridik të nevojshëm, mbi të drejtat që i njihen ligji dhe mbi kuptimin e diskriminimit që ishte kryer ndaj saj.

Në datën 02.03.2020, ankuesja shprehet se ka paraqitur padi të gjykatë në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës, fakt ky që sipas ankuses, rezulton i provuar nga vendimi i gjykatës ku është pasqyruar si datë e regjistrimit të padisë, data 02.03.2020. Ankuesja pretendon se është pikërisht data 01.03.2020, pra 1 ditë para paraqitjes së padisë në gjykatë, data në të cilën ajo ka marrë dijeni për diskriminimin që është kryer ndaj saj. Në mbështetje të pretendimeve të saj në lidhje me momentin kur ka marrë dijeni për diskriminimin, ankuesja ka depozituar vetëm faqen e parë të vendimit me nr. 785, datë 09.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ku rezulton se, çështja civile objekt shqyrtimi me palë paditëse D.O, palë të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP Berat dhe objekt zgjidhjen e kontratës së punës, ishte regjistruar me nr. 855 regj, datë 02.03.2020.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është paraqitur përtej afateve ligjore të parashikuara nga gërma “dh”, e pikës 4, të dispozitës ligjore të sipërcituar, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, formulimi në nenin 33, pika 4, germa “dh”, e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon se afati maksimal 3 vjeçar, nga momenti i ndodhjes së diskriminimit dhe afati maksimal 2 vjeçar, nga momenti i marrjes së dijeni për diskriminimin, nuk janë afate kumulative. Për t’u konsideruar brenda afateve ligjore për shqyrtimin e ankesave nga ana e Komisionerit, ankuesi mund të provojë ose se nuk kanë kaluar 3 vjet nga ndodhja e diskriminimit, pavarësisht se kur ka marrë dijeni, ose në rast se provon se momenti i marrjes së dijeni është i ndryshëm nga momenti i ndodhjes së diskriminimit, ankuesi është brenda 2 viteve nga marrja e dijeni.

Së dyti, fakti diskriminues i pretenduar nga ankuesja, sikundër shprehet edhe ajo vetë në ankesën e saj, rezulton të ketë ndodhur në datë **08.02.2017**. Ankuesja ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit në datën **24.05.2021**, pra në tejkalim të afatit 3 vjeçar të parashikuar në neni 33, pika 4, germa “dh”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Së treti, ankuesja pretendon se momenti i ndodhjes së diskriminimit është i ndryshëm nga momenti kur ka marrë dijeni për diskriminimin e pretenduar. Ankuesja pretendon se ka marrë dijeni për diskriminimin e pretenduar në datë 01.03.2020 dhe këtë moment e lidh me faktin se në këtë datë ankuesja ka marrë informacionin juridik të nevojshëm, mbi të drejtat që i njihet ligji dhe mbi kuptimin e diskriminimit që ishte kryer ndaj saj, pas konsultës që pretendon se zhvilluar me avokatin. Komisioneri vlerëson se një pretendim i tillë është i pabazuar, pasi marrja e dijeni për ligjet apo aktet nënligjore nuk lidhet me momentin kur personat mund të kenë kuptuar parashikimet ligjore, por lidhet me momentin që ligji apo akti nënligjore është botuar sipas parashikimeve dhe rregullave përkatëse në lidhje me botimin e tyre. Në këtë kontekst edhe pretendimi për marrjen e dijeni për faktin diskriminues, i cili pretendohet të ketë ndodhur në datën 08.02.2017, nuk mund të lidhet me momentin që ankuesja ka marrë informacionin e duhur juridik që i ka mundësuar asaj kuptimin e të drejtës që i është cënuar, por lidhet me momentin që ankuesja ka ardhur në dijeni të faktit diskriminues të pretenduar, pavarësisht nga forma e marrjes së dijeni, për rrjedhojë pretendimi i marrjes së dijeni për diskriminimin e pretenduar në datën 01.03.2020, rezulton i pabazuar.

Për sa kohë që ankuesja nuk provon të ketë marrë dijeni në një moment të ndryshëm nga data në të cilën ka ndodhur diskriminimi i pretenduar, pra datë 08.02.2017, atëherë prezumohet se ankuesja ka patur dijeni për diskriminimin e pretenduar që në datën **08.02.2017**. Ankuesja ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit në datën **24.05.2021**, pra në tejkalim të afatit 2 vjeçar të parashikuar në neni 33, pika 4, germa “dh”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, germa “dh”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar

dhe për rrjedhojë ankesa nuk mund të pranohet për t'iu nënshtruar procedurave të mëtejshme nga ana e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 96 Regj., datë 24.05.2021, të paraqitur nga znj.D.O kundër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijoni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore

Fusha: Punësim

Lloji i vendimit: Mospranim